



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 269 Prot.

Tiranë, më 11.04.2017

V E N D I M

Nr.79, datë 11/04/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 143, datë 30.12.2015, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhërin Nr. 810/2 prot., datë 03.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil" në Bashkinë Vau Dejës"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 143, dt.30.12.2015, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhërin Nr. 810/2 prot., dt. 03.12.2015", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërejtje:

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit Nr. 810/2 prot., dt.03.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara gjatë procesit të ristrukturimit të Bashkisë Vau-Dejës, e për rrjedhojë cënimin e marrëdhënies së punësimit të nëpunëses ***** me detyrë Administratore e Zyrës së Pronave Publike dhe Aseteve në Njësinë Administrative Hajmel, është kryer hetimi i plotë administrativ.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 143, datë 30.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhërin Nr. 810/2 prot., dt.03.12.2015", në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, rregullimin e ligjshmërisë duke vepruar si më poshtë:

- a. Të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 347, datë 11.05.2015, duke cilësuar saktë pozicionin e punës të mbajtur nga punonjësja ***** në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (datë 26.02.2014), nga "Përgjegjëse e Zyrës së Bujqësisë dhe Inspektimit Veterinar", në pozicionin

“Administratore e Zyrës së Pronave Publike dhe Aseteve”, si nëpunëse civile në periudhë prove;

- b. Të revokojë aktet administrative nr. 490 prot., datë 28.10.2015, “Mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës”, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës dhe nr. 490/1 prot., datë 09.11.2015, “Për zgjidhjen e kontratës së punës”, dalë në vazhdim të aktit të mësipërm, për shkak të shkeljes së rëndë të procedurave të kërkuara nga ligji, në nxjerrjen e tyre.*
- 2. Të kryhet procesi i ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Vau Dejës, duke filluar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe kryerjen e të gjithë procesit, duke respektuar kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; kreut III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”.*
- 3. Në rastin e pamundësisë të sistemimit të punonjësve që u është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke u njohur atyre, përfitimet që rrjedhin prej pikave 7 dhe 8 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe dy vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil, të cilat lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje dhe arsye të tjera të ligjshme.*
- 4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.*

Me kalimin e afatit procedural të parashikuar në pikën 4, të Vendimit Nr. 143, dt.30.12.2015, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin Nr. 810/2 prot., datë 03.12.2015”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkia Vau Dejës me shkresën nr. 160/1 prot., dt.04.07.2016, ka njoftuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në dispozitivin e vendimit.

Për shkak të mangësive të konstatuara në dokumentacionin e dërguar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vau Dejës, me shkresën nr. 2827 prot., datë 10.11.2016, “Dërgim aktesh”, ka dërguar aktet e kërkuara, të cilat materializojnë zbatimin e vendimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezultoi se:

Në zbatim të pikës 1/a të Vendimit nr. 143, datë 30.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Vau Dejës, me anë të aktit të deklarimit nr. 160/14 prot., datë 04.07.2016 ka ndryshuar aktin e deklarimit nr. 347, datë 11.05.2015, duke cilësuar saktë pozicionin e mbajtur nga punonjësja ***** në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, nga “Përgjegjëse në Zyrën

e Bujqësisë, Veterinarisë dhe Kadastrës” në pozicionin “Administratore e Zyrës së Pronave Publike dhe Aseteve” në Njësinë Administrative Hajmel.

Në vijim, të akteve administrative nr. 490 prot., datë 28.10.2015, “Mbi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës”, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës dhe nr. 490/1 prot., datë 09.11.2015, “Për zgjidhjen e kontratës së punës”, njësia përgjegjëse në Bashkinë Vau Dejës ka dalë me Vendimin nr. 07, datë 07.01.2016 “Për zgjidhjen e kontratës së punës duke respektuar afatet e njoftimit me punëmarrësin e Njesisë Administrative Hajmel, *****”, në pozicionin P/Zyrës së Bujqësisë”.

Më tej, njësia përgjegjëse, pasi është njohur me vendimin e Komisionerit, ka konstatuar kundërligjshmërinë e Vendimit nr. 07, datë 07.01.2016 “Për zgjidhjen e kontratës së punës duke respektuar afatet e njoftimit me punëmarrësin e Njesisë Administrative Hajmel, *****”, në pozicionin P/Zyrës së Bujqësisë”. Për këtë arsye, me Vendimin nr. 7/1, datë 04.07.2016, ka vendosur revokimin e Vendimit Nr. 07.01.2016, “Për zgjidhjen e kontratës së punës duke respektuar afatet e njoftimit me punëmarrësin e Njesisë Administrative Hajmel, *****”, në pozicionin P/Zyrës së Bujqësisë”, me anë të të cilit është finalizuar vendimmarrja e institucionit Bashkia Vau Dejës për largimin nga puna të punonjësës *****.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Vau Dejës, në zbatim të pikës 2 të vendimit, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me anë të Urdhrit nr. 51, datë 18.04.2016, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit të Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative pjesë e saj, në respektim të nenit 50 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 171, dt. 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”.

Në zbatim të pikës 3 të vendimit, Komisioni i Ristrukturimit i Bashkisë Vau Dejës, në pamundësi për sistemimin e punonjësës *****”, të cilës i është shkurtuar pozicioni i punës, me shkresën nr. 160/16 prot., dt.04.07.2016, njësia përgjegjëse e ka njoftuar për lirimimin nga shërbimi civil dhe kalimin në listë pritje 2-vjeçare sipas përcaktimeve të pikave 7 dhe 8 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar .

Sa më sipër, konstatoj se, Vendimi Nr. 143, datë 30.12.2015, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin Nr. 810/2 prot., dt. 03.12.2015”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, Bashkia Vau Dejës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 143, dt.30.12.2015, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin Nr. 810/2 prot., dt. 03.12.2015” në institucionin, Bashkia Vau Dejës.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 143, datë 30.12.2015, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin Nr. 810/2 prot., dt. 03.12.2015*”.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Vau Dejës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA